

AKTI I THEMELIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“epay.al” sh.p.k.

Sot më datë 09.12.2022 në Tiranë, une i nenshkruari Endri MEKSI, shtetas shqiptar, lindur më 01.07.1979, në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i kartes se identitetit me nr. personal H90701154E,
në mbështetje të Ligjit nr. 9091 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, të Ligjit Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe legjislacionit shqiptar të zbatueshëm:

Vendosa:

të nënshkuaj Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (këtu e më poshtë referuar Shoqëria), aktiviteti i të cilës rregullohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe Statutit të saj i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi, të cilit i bashkëngjitet.

Neni 1

Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Shoqëria është krijuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Emërtimi i shoqërisë është “epay.al” sh.p.k (këtu e në vjim e referuar Shoqëria).

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “epay.al” sh.p.k është në adresën: Njësia Administrative Farke, Rruga e Lundrës, ‘Kodra e Derhemëve’, Nd. nr.2, Farkë, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3

Objekti i Aktivitetit

- 3.1 Objekti i Aktivitetit së Shoqërisë do të jetë kryerja e aktivitetit financiar të Institucionit të Pagesave në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencat e dhëna nga autoritetet përgjegjëse të përcaktuara me ligj.
- 3.2 Objekti i Shoqërisë do të përfshijë dhënie dhe shërbimeve këshilluese dhe shërbimeve të tjera ndihmëse për aktivitetin kryesor sipas parashikimeve të ligjit.
- 3.3 Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu aktivitete të tjera financiare jo-bankare në përputhje me të drejtat e dhëna nga autoritetet përgjegjëse të caktuara me ligj.



Neni 4

Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pakufizuar.

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë "epay.al" sh.p.k, është 16,000,000 (gjashtëmbëdhjetë milion) Lekë dhe përfaqëson 100% të kapitalit, ku:
Ortaku themelues është Z. Endri Meksi, i cili zotëron 1 kuotë me vlerë të përgjithshme 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 5.2 Kapitali është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortaku i vetëm, Z. Endri Meksi.
- 5.3 Kuotat e Ortakut/ve regjistrohen në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.
- 5.4 Pjesët e kapitalit janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo moment sipas kushteve dhe afateve të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

Neni 6

Ortaku i Vetëm

- 6.1 Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.
- 6.2 Ortaku i Vetëm është z. Endri Meksi, i biri i Aleksandrit, i datëlindjes 01.07.1979 lindur dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartes se identiteti me nr. personal H90701154E.

Neni 7

Administratori i Shoqërisë

- 7.1 Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratori.
- 7.2 Administratori emërohet me Vendim të Ortakut të Vetëm dhe qëndron në këtë detyrë për një afat jo më të gjatë se 5 vjet. Administratori mund të rizgjidhet për të njëjtën periudhë me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 7.3 Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. Endri Meksi.

Neni 8

Viti Financiar

- 8.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbyllet më 31 Dhjetor.



Neni 9

Audituesi Ligjor

- 9.1 Auditimi i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga një ose shumë ekspertë kontabel të regjistruar të emëruar me vendim të Ortakut të Vetëm për çdo vit financiar në përputhje me kriteret dhe rregullat e përcaktuara nga kuadri ligjor e rregullator në fuqi.

Neni 10

Prishja dhe Likuidimi

- 10.1 Ortaku i Vetëm mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me likuidimin e saj.
- 10.2 Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik vetëm për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi dhe gjatë likuidimit, togfjalëshi “në likuidim e sipër” duhet të vihet pas emrit të shoqërisë.

Neni 12

Gjuha

- 11.1 Ky Akt Themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “epay.al” sh.p.k është përpiluar në katër kopje në gjuhën shqipe me vlerë të barabartë.

Tiranë, më 09.12.2022

ORTAKU I VETËM

ENDRI MEKSI

